



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1288/24 Prot.

Pogradec, më 31.03.2026

VENDIM

Nr. 37, Datë 30.03.2026

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR Z. KLAJDI AFESLLARI, FAMILJE QË KA PËSUAR DËME NË ORENDI/PAJISJE SI PASOJË E PËRMBYTJES”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 gërma “gj”, të Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Të akordojë ndihmën financiare për Z. Klajdi Afesllari **145173** (Njeqind e dyzet e pese mije e njeqind e shtatedhjete e tre) Lekë, familje që ka pësuar dëme në orëndi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve në banesë nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm të dates 07.01.2026.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga komisioni përkatës pranë Bashkia Pogradec.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile, të parashikuar në Buxhetin e vitit 2026, të Bashkisë Pogradec.



4. Ndhimja financiare që do të akordohet, do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit z.Klajdi Afesllari, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.
 5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave dhe Strehimit, Pronësia dhe Bashkëpronësia, Administrimit të Tokës dhe Supervizimit të Sherbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 21 **vota**

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.03.2026